



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS  
(KQZ UP)**

**NJOFTIM PËR ZGJEDHJET STUDENTORE 2024**

**8 Mars 2024**

Të nderuar përfaqësues të Organizatave Studentore,

Siç jeni informuar, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 07.3.2024, ka nxjerrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe po ashtu ka emëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ UP), në përbërje prej tre (3) anëtarëve.

Sipas pajtimit të KQZ UP me të gjitha Organizatat Studentore, zgjedhjet studentore do të mbahen me **3 Prill 2024, në mënyrën ONLINE.**

Përgjatë kohës së zgjedhjeve studentore, KQZ UP punën e saj e bazon në **Rregulloren nr. prot: 753, 7.3.2024 për procedurat zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina.** Bazuar në këtë rregullore do të zhvillohet edhe procesi zgjedhor, në zgjedhjet studentore 2024.

Duke pasur parasysh që kjo është hera e tretë e mbajtjes së zgjedhjeve studentore në mënyrë elektronike (online), KQZ UP do të marrë të gjitha masat e sigurisë që zgjedhjet studentore të zhvillohen në mënyrën më të mirë të mundshme, me qëllim që të ketë një proces zgjedhor me integritet dhe objektiv që mundëson organe kredibile të përfaqësimit studentor në të gjithë Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Mbi të gjitha, KQZ UP do të marrë për bazë edhe problemet janë paraqitur, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve online në vitin 2022 dhe të njëjtat do të adresohen, në sistemin elektronik të mbajtjes së zgjedhjeve online, të caktuara **me 3 Prill 2024.**

Po ashtu me qëllimin që procesi zgjedhor me votim elektronik (online) të jetë sa më i besueshëm dhe i sigurt, KQZ UP do të certifikojë vëzhguesit e organizatave studentore dhe organizatave të tjera që janë të interesuar të monitorojnë mbarëvajtjen e votimit elektronik. Në këtë linjë, KQZ UP do të bashkëpunojë për monitorim të procesit zgjedhor me institucionet kompetente ligjzbatuese, veçanërisht Policinë e Kosovës, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, të interesuar për monitorimin e zgjedhjeve studentore 2024.

Vendimmarrja e KQZ UP do të jetë transparente. Një vendimmarrje e tillë mundësohet veçanërisht përmes pjesëmarrjes në KQZ UP të anëtarëve vëzhgues të organizatave studentore. Në të gjitha mbledhjet e KQZ UP do të ftohen anëtarët vëzhgues, të caktuara nga organizatat studentore.

Mbledhjet e KQZ UP po ashtu janë të hapura për pjesëmarrje edhe të palëve dhe organizatave tjera si dhe mediave, me qëllim të monitorimit.

KQZ UP inkurajon të gjitha organizatat studentore që në mënyrë sa më masive të marrin pjesë në zgjedhje dhe të mundësojnë një garë fer dhe demokratike, me qëllim që studentët e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të kenë mundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës për t’i zgjedhur përfaqësuesit në organet përfaqësuese të studentëve.

Për këtë qëllim, KQZ UP, përveç këtij njoftimi, bashkëngjitur ju dërgon dokumentet si në vijim:

1. Rregulloren me nr. prot. 753, 7.3.2024 për procedurat zgjedhore, themelimin dhe punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
2. Dinamikën e procesit zgjedhor për zgjedhjet e studentëve, miratuar me datë 08.03.2024 nga KQZ UP.

Të gjitha dokumentet e nxjerra nga KQZ UP, gjatë procesit zgjedhor do të jenë të qasshme në ueb faqen e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Për këtë qëllim do të krijohet edhe një link i veçantë.

Ndër të tjera, të gjitha komunikimet me ju si dhe njoftimet KQZ UP do t’i zhvillojë fizikisht dhe virtualisht. Me qëllim të komunikimit, duhet të shfrytëzoni për komunikim emailin zyrtar të KQZ-së, [kqz@uni-pr.edu](mailto:kqz@uni-pr.edu).

Pikë kontakti e organizatave studentore me KQZ UP-në janë vetëm përfaqësuesit e autorizuar që i cakton organizata studentore përkatëse. KQZ UP gjithashtu, do të mbajë edhe takime, sipas nevojës me organizatat studentore përgjatë zbatimit të dinamikës zgjedhore.

Sa më sipër, duke pasur parasysh rëndësinë e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, e cila është e mundshme vetëm me mbështetjen tuaj, kërkojmë nga të gjitha organizatat studentore që t’i përmbahen me përpikëri datave të caktuara në dinamikën zgjedhore, përndryshe KQZ UP nuk do të mund të konsiderojë kërkesat që vijnë jashtë afateve të përcaktuara në këtë dinamikë.

KQZ UP zotohet se do t’i kryej detyrat e saj në bazë të rregullave ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke u bazuar në përgjegjësi dhe integritet të lartë profesional dhe etik.

KQZ UP është e hapur për bashkëpunim dhe ju falënderon paraprakisht për kontributin tuaj, që procesi i zgjedhjeve studentore 2024, të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Me respekt,

**KQZ UP**

1. **Prof.Ass.Dr.Florent Muçaj – kryesues,**
2. **Prof.Ass.Dr.Kujtime Boshtrakaj-Camaj – zv. kryesuese,**
3. **Besfort Krasniqi (Sekretar i Përgjithëshëm i UP) – anëtar dhe sekretar i KQZ UP.**